



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 01-325-05-5052-24

Nr. i fq. / Br.str. / No.pg.

Data / Datum / Date 15.02.2024

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.24.01.2024, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti, Bajram Hashani, Labinot Mirena dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: Drejtorët komunal dhe Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun
Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit të Kuvendit Komunal për vitin 2023
4. Raporti financiar i shpenzimeve Janar-Dhjetor 2023
5. hqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

Kryesuesja – Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, më lejoni së pari të ju uroj fillimin e vitit meqë, jemi në takimin e parë të këtij viti në Komitet, duke ju uruar shëndet dhe suksese në vazhdimësi, Po ashtu ju falënderoj për bashkëpunimin që keni treguar gjatë vitit 2023.

Pastaj, kryesuesja i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti Raportin e Kuvendit Komunal për vitin 2023 dhe tha se ky raport është pak më i thjeshtë se ai i vitit të kaluar ku kemi rekomanduar me u heqë datat e mbajtjes së mbledhjeve si dhe vendimet që janë marrë në muajt e caktuar. Gjithsejt i kemi miratuar 66 vendime dhe 4 vendime janë të kthyera për shfuqizim gjatë vitit 2023.

Enver Gashi – Edhe unë fillimisht ju uroj një vit të mbarë të gjithëve me shpresë se do të kalojmë më mirë se në vitin 2023. Sa i përket kësaj pike ne jemi për atë që të shkoj në Kuvend dhe atje të debatojmë.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi dakord që ky raport të shkoj për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal dhe nuk kemi ndonjë vërejtje për momentin, kështu që do të bisedojmë në seancë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e Raportit të Kuvendit Komunal për vitin 2023.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën e DEFZH-së, për shqyrtimin e raportit financiar të shpenzimeve janar-dhjetor 2023.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që raporti financiar i shpenzimeve të kaloj në Kuvend dhe ndonjë vërejtje, apo sugjerim aty të prezantohet.

Sami Ahmeti - Është raport i rregulltë që duhet dhe është obligativ ti vjen Kuvendit. Ne jemi dakord që ky dokument të shkoj në seancë ndërsa, atje do të kemi shumë pyetje, kështu që shpresoj se personat përgjegjës do të jenë në sallë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e Raportit financiar të shpenzimeve Janar-Dhjetor 2023.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga Kryetari i Komunës, për shqyrtimin e Planit të Punës të Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit Komunal për vitin 2024 dhe Planifikimin Përfundimtar i Prokurimit si dhe të përfshihet në pikën e 5-të të rendit të ditës për mbledhjen e Kuvendit.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që kjo pikë të përfshihet si pikë e pestë e rendit të ditës për Kuvend dhe të debatohet.

Sami Ahmeti – Tani, ju e thatë se e keni një kërkesë, por ne si anëtarë të KPF-së, nuk e kemi. Unë nuk e di pse ka nevojë do të thotë që me ardhë vetëm tani, e mos me na ardhë sipas planit dhe jo pse jemi kundër por pse me u anashkalue këto procedura, pse mos me na ardhë me kohë materiali. Për këtë arsye ne do të abstenojmë.

Kryesuesja – Sqaron se kërkesa ka ardhë dje me dt.23, nuk e di në sa ora sepse unë kam pasë një takim me kryesues, prandaj edhe e paraqita nëse jeni dakord që ta keni për mbledhjen e Kuvendit.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 5 vota për dhe 2 vota abstenim ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e Planit të Punës të Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit Komunal për vitin 2024 dhe Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit si dhe të përfshihet në pikën e 5-të të rendit të ditës për mbledhjen e Kuvendit.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja - Meqë, në këtë pikë nuk kemi diskutime atëherë edhe e përfundoj mbledhjen e sotme.

Mbledhja përfundoi në ora 11:14'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

